



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR NXJERRJEN E REZULTATIT TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË  
BASHKISË SHKODËR, QARKU SHKODËR, NË ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 30  
QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

**OBJEKT:** Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, në zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a", neni 123, neni 166, pika 1 të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjo diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**VËREN**

Zona Zgjedhore Bashkia Shkodër, territori i saj është i ndarë në 4 ZAZ. Në këtë rast KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatin për zonën zgjedhore, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Në përfundim të procesit të dorëzimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve dhe Tabelave të Rezultateve për çdo qendër votimi për Kryetarin e Bashkisë Shkodër nga të 4 KZAZ-të e kësaj bashkie, KQZ, nxjerr rezultatin për këtë zonë zgjedhore, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit.



Përpara plotësimin të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, u krahasuan Tabelat e Rezultatit për kandidatët për kryetar të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuara nga Grupet e Numërimit me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të miratuara nga KZAZ nr.02, KZAZ nr.03, KZAZ nr.04, KZAZ nr.05 dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, rezultoi se:

- Tabela Përmbledhëse e Rezultateve, e miratuar nga KZAZ nr.02, nuk përfshin rezultatin e votimit të QV nr. 0077; QV nr. 00771; QV nr. 00791; QV nr. 0082; QV nr. 0083; QV nr. 0086; QV nr. 00861; QV nr.0224 ; QV nr. 0345.

- Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të miratuara nga KZAZ nr.03, KZAZ nr.04, KZAZ nr.05 përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve që kanë këto ZAZ.

- Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me tabelat përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së përkatëse dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, u vërejtën mospërputhjet e shifrave si më poshtë:

ZAZ 2	QV	GN	TPR	SISTEM
Femra - kryetar	91	62	2	2
Fletë votimi të paperdorura	110	892	852	852
Fletë votimi të paperdorura	0119/2	238	38	38
Fletë votimi të paperdorura	2201	446	46	46
Partia SocialDemokrate	0341	33	0	0
Partia Socialiste	0341	2	33	33
Bindja Demokratike	0341	0	2	2

ZAZ 04- Kryetar	QV	GN	TPR	SISTEM
Fletë votimi të gjetura ne kuti	0248	0	90	90
Fletë votimi të gjetura ne kuti	0249	0	119	119
Fletë votimi të gjetura ne kuti	0252	0	58	58
Fletë votimi të gjetura ne kuti	0255	0	73	73
Fletë te demtuara	0255	0	4	4
Fletë votimi të gjetura ne kuti	0259	0	63	63
Fletë votimi të gjetura ne kuti	02591	0	67	67
Fletë votimi të gjetura ne kuti	0267	0	91	91
Fletë votimi të gjetura ne kuti	02671	0	44	44
Fletë të pa perdorura	0319	0	321	321

Nr.	QV	ZAZ 5 Shkodër / Kryetar	GN	TPR	SISTEMI
1	0285	Flete votimi te paperdorura	713	73	73
2	03171	Flete votimi te paperdorura	491	49	49



Nga verifikimi i dokumentacionit të KZAZ nr. 02, Librit të Protokollit të Mbledhjeve rezulton se në QV nr. 0077; QV nr. 00771; QV nr. 00791; QV nr. 0082; QV nr. 0083; QV nr. 0086; QV nr. 00861; QV nr.0224 ; QV nr. 0345, në datë 30 Qershor 2019, votimi nuk është zhvilluar.

KQZ do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, me shifrat e korrigjuara, mbështetur në tabelat e rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore dhe tabelat origjinale të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj bashkie, të plotësuar nga grupi i numërimit të votave përvec QV nr. 0077; QV nr. 00771; QV nr. 00791; QV nr. 0082; QV nr. 0083; QV nr. 0086; QV nr. 00861; QV nr.0224 ; QV nr. 0345, si dhe të shpall fitues kandidatin për kryetar, Bashkia Shkodër.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a" nenin 123 dhe nenit 166, pika 1, të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të shpallë fitues për Kryetar të Bashkisë Shkodër z. Valdrin Luigj Pjetri të propozuar nga Aleanca për Shqipërinë Europiane.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykates së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>

